



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prijmjen/Prodato Received/Delivery	10 - 03 2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSTHEK	1087/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.32/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-Kryetare e Kolegjit, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.32/2021 të datës 26.01.2021 të parashtruar nga ankuesja nga Komuna e Pejës, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 10.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.32/2021 të datës 26.01.2021 të parashtruar nga ankuesja**
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.**

A r s y e t i m

Ankuesja, e punësuar në Policinë e Kosovës sipas kontratës së punës me numër Nr.Ref.07/1-01A/0729 të datës 22.09.2014, në pozitën "Pastruese", në Njësinë Rajonale të Komunikacionit Rrugor në Pejë, me datë 26.01.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për mos përfshirjen në pakon emergjente COVID-19, për muajin nëntor 2020.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 02.02.2021, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Policinë e Kosovës. Me datën 10.03.2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Policia e Kosovës me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 26.01.2021 me Nr.Prot:306/2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili zyrtar i datës 06.01.2021; Lista e zyrtareve të angazhuar në muajin tetor dhe nëntor 2020 NJRKRR-Pejë; E-maili zyrtar i datës 18.01.2021; E-maili zyrtar i datës 08.01.2021, Përgjigja në kërkesë e datës 10.03.2021; Kontrata e punës e ankueses e datës 22.09.2014; Përshkrimi i detyrave të punës i ankueses i datës 24.08.2015; Emali zyrtar i datës 09.10.2020; Emali zyrtar i datës 18.01.2021; Emali zyrtar i datës 24.02.2021; Emali zyrtar i datës 06.01.2021; kartela e nëpunësit Janar 2020 Dhjetor 2020; Vendimi i KZKA-së i datës 25.01.2021; Emali zyrtar i datës 18.02.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar dehmive të ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit, konstaton se ankuesja është në marrëdhënie punë në Policinë e Kosovës respektivisht në Njësinë Rajonale të Komunikacionit Rrugor në Pejë sipas kontratës së punës me numër Nr.Ref.07/1-01A/0729 të datës 22.09.2014, në pozitën "Pastruese".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se të punësuarit që kryejnë veprimtari ndihmës dhe të mirëmbajtjes, në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk i takojnë shërbimit civil respektivisht janë kategorizuar si nëpunës administrativo-teknik dhe mbështetës ashtu siç përcaktohet me nenin 2 paragrafin 6 ku theksohet se: *6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.* Andaj, duke marrë parasysh se ankuesja tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i përket kategorisë së nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status të shërbimit administrativo-teknik dhe mbështetës.

Ndërlidhur me këtë pjesa VII e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësit administrativ dhe mbështetës, ku neni 82 i këtij ligji, përcakton se: *"Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës"*, mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për



Shërbimin Civil i Kosovës shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, atëherë udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike sipas nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente"*.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.32/2021

Ardita Perçuku-Shyti

gr. Behtalini
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës ;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

